

On the history of the censorship of book production in the Albanian language (16th-17th centuries)

Abstract: *The identification of the most important samples of works of Old Albanian literature remains an essential element in the entire study panorama related to the history of each work and data which serve to understand that specific details can be traced on each one, just like the respective content of the compilation itself.*

"Indexes of Prohibited Books" inevitably included books of Christian liturgy and the practice of its knowledge, a fact underscored by the examination of some of them, particularly registers compiled during the 16th century, in the years of the Council of Trent, but also after its conclusion. Spread over time and in specific geo-cultural contexts, the above-mentioned indexes are also a rich source of data on works, books, volumes in various fields of knowledge, complete versions of the Bible which required revision or rewriting, as well as separate parts from the Old and New Testaments.

The role of Church censorship is evident in different ways in specific areas of the culture of book circulation such as literature, philosophy, humanities, etc.

Keywords: *Censorship, Index, Church Book, Church Literature.*

Në një përpjekje për të analizuar bindshëm e në mënyrë objektive përdorimin e termit "libër i ndaluar" në studimet shqiptare, nuk mund të mos marrim në konsideratë një sërë studimesh që me pikënisje vetë dukurinë e censurimit të botimeve të caktuara në periudha që lidhen më së pari me Koncilin e Trentit (1545-1563) dhe dekretet e tij të lidhura edhe me këtë tematikë, hedhin dritë mbi zhvillime që lidhen veçanërisht me botën e librit të shtypur dhe qarkullimin e tij.

Bibla në veçanti, tekstet përkatëse me orientim ndaj celebrimit liturgjik, por dhe këngët e veçanta që kanë gjetur reflektim disashekullor dhe në kulturën tonë, janë objekt trajtimi dhe në studimet tematike mbi librat e ndaluar, apo librat që në njëfarë mënyre duhet t'i nënshtroheshin mbikëqyrjes apo rishikimit të detyruar, nganjëherë dhe në dimensione të

një rreptësie të qartë e të diktuar. Krejt spektri i prodhimitarisë librare së realizuar në shekujt që përkojnë me përrurimin e shtypshkrimit lidhet në mënyrë të pandashme me një sërë hallkash që luajnë një rol këqyrjeje mbi botimet e përveçme për nga tematika dhe destinacioni përkatës, fakt që përfshin pa dyshim dhe librin kishtar dhe veçanërisht atë të paracaktuar për praktikën liturgjike.

Në lidhje me veprat e letërsisë së vjetër shqipe, vetë mbikëqyrja, revizionimi përmbajtësor dhe tekstet përkatëse që arrijmë të gjurmojmë në pjesë të caktuara të tyre e reflektojnë një fakt të tillë, më qartë, njohjen prej vetë përpiluesve të autoritetit hierarkik mbikëqyrës, të artikuluar dhe në emërtesa të posaçme, që lexohen qartë në hyrje, në faqet e para, apo dhe deduktohen në pjesët përmbyllëse me të cilat vetë përpiluesi kërkon të paraqitet para lexuesit të tij. Të tilla vepra, të realizuara në një hark kohor që nuk përjashton ndikimet e dekretëve të Koncilit të Trentit ofrojnë shtysa që pikërisht dhe në referim ndaj studimeve të arsyetuara mbi kontekstin evropian dhe atë italik në veçanti të gjurmohen figura që përbënin dhe një faktor të rëndësishëm në aprovimin për shtyp të tyre.

Ndër këto vepra, do të dallojmë pa dyshim për nga përmbajtja fizike dhe elemente që duhet të na orientonin më së miri ndaj vetë historikut përkatës të librit të Gjon Buzukut, për të cilin flitet në disa burime dhe në shekullin XVIII, periudhë në të cilën dhe Imzot Gjon Nikollë Kazazi realizon doktrinën e krishterë të miratuar nga Kongregacioni i Propagandës, por njëherësh lë dhe gjurmë të një letërkëmbimi në të cilin bën fjalë për "*një meshar të vjetër, të shqyer nga vjetërsia*".¹

Është folur gjatë e gjerësisht për këtë vepër, të bërë objekt diskutimi si në studimet mbi historinë e shkrimit shqip, ashtu dhe në ato që lidhen me historinë e letërsisë së shkruar shqipe, në të cilat nënvizohet mungesa e faqeve të para, që në përputhje me përmbajtjen e librave të ngjashëm për nga përbërja dhe ndërtimi, duhet të kenë elemente të një përkatësie të qartë në lidhje me vetë modelin libror gjegjës, me kalendarin liturgjik vjetor që citohet e renditet në një radhë të arsyetuar në libra të kësaj natyre, por dhe të tjera indice që i japin këtij ekzemplari dhe një ubikim konkret për nga destinacioni i përdorimit, si dhe vendi i botimit apo tipografia nga e cila duhet të kishte dalë.²

1 G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese* (a cura di M.Mandalà), Edizioni Mirror, Palermo, 2003, f. 98: Questo è l'antichissimo Messale Albanese per antichità tutto stracciato che S.E. l'Arcivescovo di Scopia Monsignor Don Giovanni Battista di Nicola Casasi, albanese di Giacova, verso l'anno 1740 aveva con meraviglia visto a Roma nel Collegio di Propaganda. Volle da esso trascrivere di proprio pugno un esemplare dell'ultima pagina, lieto di mandarlo in dono all'inclito P. Giorgio Guzzetta, fondatore del Seminario albanese in Palermo e di altri Istituti albanesi, prototipo delli spiriti magnanimi e dell'animo e della generosità della nazione albanese.

2 Kjo mungesë fizike e faqeve më të para, ashtu si dhe e frontespicit përbën jo vetëm

Mungesa e faqeve të para e që bën të mendohet se mund të kenë përmbajtur elemente të një kalendari vjetor të përcaktuar, u ka dhënë shkas hipotezave mbi arsyet e gjetjes së tij në një gjendje të tillë fizike, por dhe supozimit të ndalimit a moslejimit të supozuar për të cilin më konkretisht dhe sot e kësaj dite do të duhej të na ndihmonin indekset e librave të ndaluar, në veçanti ato të përmbyllura pas vitit 1555.³

Pyetje që lindin natyrshëm në rasë të diskutimit rreth një ekzemplari të tillë janë dhe ato që nënkuptojnë ndalimin e qarkullimit të një libri që përmban disa modele që ndiqen në vijimësi në përbërje të tij, duke qenë se më tej mund të kenë pasur përdorim dhe doracakë të veçuar nga njëri-tjetri, siç rezultojnë me përmbledhjet doktrinare të shekullit XVII që përmbajnë më shumë rubrika të bashkëbisedimit mes xhakoit dhe dishepullit, por dhe pjesë nga tekstet biblike, për më tepër me shprehje e ndërtime në latinisht dhe në rastin e botimeve në gjuhët vernakolare.⁴

Librat e ndaluar dhe kategorizimi në pikëpamje tematikash përbëjnë dhe një argument interesant diskutimi, duke qenë se në evidentimin e tyre në indekse e në vëllime që në disa raste paraqiten dhe me tituj specifikë

një element për t'u nënvizuar në pikëpamje të rindërtimit të profilin përfaqësues të veprës, por dhe një arsye më shumë për të vënë në dukje që pikërisht mbi të tilla indice përpilohen studime më vete, madje dhe të thelluara, duke qenë se në një Meshar mund të gjindej i konsultueshëm lirisht dhe një kalendar paraprijës mbi liturgjinë dhe hapat celebrativë gjatë vitit liturgjik, por dhe figura shenjtorësh që kishin një lidhje të përveçme me vetë destinacionin përkatës të librit. Për lidhjen me shenjtorë të caktuar mund të konsultohen dhe shënimet e posaçme të Mario Roques në veprën e tij të mirënjohur *"Recherches sur les anciens textes albanais"*, Paris, 1932, f.15-16. Rreth shënimeve specifike të filologut frëng M.Roques do të gjejmë një argumentim të ndryshëm dhe një interpretim të dhënash mbi aspekte fizike të këtij libri nga M.Camaj në veprën e tij të mirënjohur *"Il Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shënjat, Roma, 1960, *Introduzione*, f.8-9, duke mbetur në të vërtetë dhe një shtysë më shumë për të marrë në konsideratë dhe mendime të tjera në lidhje me qarkullimin e ekzemplarëve librorë në shekullin XVI në arealin italik. Dhe pse një vepër e orientuar ndaj shqyrtimit në disa nënsisteme të teksteve të librit të Buzukut, në këtë punim studimor të Camajt do të gjejmë më se një herë të rimarra tezat e filologut frëng mbi fatin e këtij ekzemplari dhe njohjen nga ana e përpiluesit të tij të modeleve të ngjashme dhe në arealin kroat, fakt që është analizuar me vëmendje dhe prej vetë Camajt. Një terminologji e përveçme në lidhje me një ndikim të tillë (shih *poaty, vepër e cituar*, f.11-12) është përdorur prej këtij të fundit duke bërë të plotësohet dhe panorama e kontributeve mbi historikun e librit të parë të njohur deri më sot të shkruar në gjuhën shqipe.

- 3 Një ndër burimet më të cituara mbetet dhe Indeksi i vitit 1559, i cilësuar për ashpërsinë e direktivave që përmbante dhe për një kategorizim të botimeve të përfshira në të. Në këtë indeks që i paraprin atij të vitit 1564 përmbahen dhe vepra për të cilët nuk cilësohet autori; përmbahen gjithashtu dhe botime të plota të Biblës apo të varianteve të Besëlidhjes së Re të përkthyer në gjuhët vernakolare, për të cilat lejimi nga ana e hierarkisë kishtarë përbënte një premisë të domosdoshme.
- 4 I. Zamputi, *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986, f.189-190.

mund të vihet re njëfarë ndarjeje në çështje të lëndës përmbajtësore, disiplinave të studimit, duke përfshirë si ato humanet, si dhe ato të lidhura me orientime më ekzakto, por gjithsesi jo të ndara në mënyrë të prerë me të mësipërmet. Librat kishtarë kanë qenë gjerësisht të diskutuar në pikëpamje të kompaktësisë tekstore dhe përmbajtësore, aq më tepër që për to flitet qartë në indeksat e librave të ndaluar, të sistemuar në krerë e kapituj të veçantë, në të cilët do të gjendet vend e hapësirë dhe për të saktësuar cilit autoritet i përkiste lejimi, dhënia e lejes për të konsultuar një botim të caktuar, por dhe vetë approbatur-i në lidhje me përmbylljen e procesit të botimit a të daljes në dritë të shtypit.⁵

Në çështje të të dhënave që ofrohen në proces të konsultimit të një indeksi librash të ndaluar, hulumtimi në tituj, tematika, emra autorësh apo përpiluesish përbën një proces njohjeje të vyer, por në një kuptim tjetër, duke reflektuar mbi fatin e veprave që përmenden dhe që kanë qenë objekt i një mbikëqyrjeje rreptësisht kritike, natyrisht mendohet dhe për mundësitë e humbura në pikëpamje të qarkullimit të tyre, apo të njohjes së drejtpërdrejtë të tyre nga lexues të interesuar.⁶

Një prej çështjeve jo pak të rrahura që kanë të bëjnë me librin e Buzukut mbetet dhe emërtimi më i përshtatshëm i tij duke pasur parasysh ç'përbante dhe në ç'masë në këtë brendi të tijën reflektohen elementet e një meshari, që njëherësh nënkupton dhe një liturgjiar apo një doracak që mund të përdorej gjerësisht në praktikën e përditshme të celebrimit të liturgjisë së orëve dhe atë të meshëve.⁷ Një kalendar i mirëfilltë shtjellohet në rubrikat e krerëve që e ndërtojnë atë, duke qenë ndihmëse në këtë drejtim dhe vetë mbiemërtimet që orientojnë ndaj ndjekjes së ecures së meshëve, apo të përmendjes së festave fetare në pjesë të ndryshme të

5 Një moment në të cilin njohja e tyre nga ana e autoriteteve kishtarë paraqet rëndësi është dhe ai i reflektuar në kërkesën që Gjon Nikollë Kazazi i drejton Selisë së Shenjtë (dhjetor 1740), duke nënvizuar njëherësh dhe nevojën e pajisjes së klerikëve me libra të mësimi të fesë, fakt ky që cilësohet dhe në studimet biografike mbi veprimtarinë baritore të këtij të fundit. Në lidhje me cilësimin e teksteve doktrinare që nevojiteshin për edukimin kateketik dhe fetar të popullsisë së krishterë nga ana e klerikëve dhe librat e ndaluar për të cilët Kazazi duhet të ishte në dijeni, shih në veçanti B.Demiraj, Në dioqezën e Shkupit si misionar apostolik, në *Gjon P.Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006, f.52-55.

6 Me librat e ndaluar është synuar të lidhet dhe historia e librit të parë të njohur deri më sot në gjuhën shqipe e të sipërcituar, ashtu siç lidhet me hallkat e funksionimit të censurës kishtarë dhe vetë historiku i veprave që panë dritën e shtypit në shekullin XVII, duke mbartur të cituara krejt qartë emërtimet e hallkave që lidhen me lejimin e tyre apo thënë ndryshe, me miratimin për shtyp.

7 Për emërtimin "*Livre d'heures et missel*" (traduits par Gjon Buzuk) shih sërish M. Roques, *vepër e cituar*, f.10; për një rimarrje të këtij argumenti shih gjithashtu dhe J. Matzinger, *L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale ("Messale") di Gjon Buzuku*, në *Hylli i Dritës*, nr. 4, 2010, f.54-70.

vitit.⁸ Në botimet kritike që përbëjnë dhe mjetet më të afërta në pikëpamje të leximit më të lehtësuar të teksteve të tij, gjenden dhe shpjegime mbi këto pjesë përbërëse, që natyrisht dhe ndahen mes tyre për nga natyra dhe destinacioni.⁹

Me botimin e *Doktrinës së krishterë* në gjuhën shqipe nga Pjetër Budi (1566-1622) mbi një model paraekzistues të përpiluar nga Roberto Bellarmino S.I. në vitin 1618 e që përkon me një periudhë në të cilën ky i fundit ishte në përmbyllje të jetës së tij, mund të flitet qartë për praninë e censorit si një figurë që kishte një rol të qartë në ecurinë e botimit të veprës e të miratimit të tij për shtyp. Botuesi i doracakut doktrinar të përshtatur nga Pjetër Budi përmendet në vëllime që i kushtohen bibliofilisë, botës së kulturës së librit në shekullin XVII, e siç do të vërehet dhe më tej, do të vijojë të jetë aktiv po me shtypjen e veprave të tilla dhe më vonë, kur Tipografia e Kongregacionit të Propaganda Fide-s do të jetë një ent botues mjaft i rëndësishëm në lidhje me vepra të kësaj natyre.¹⁰

Ndërmjetperiudhës që lidhet me botimin e librit të Buzukut dhe dekadave të para të shekullit XVII themelohen ente të mbikëqyrjes së prodhimit të librave që pa dyshim prekin dhe atë të librit kishtar e të modeleve të përveçme të tij, një pjesë e konsiderueshme e lidhur me breviarët, ritualin roman dhe pa dyshim dhe me mesharin. Doracakut doktrinar në thelb paraqitet më i thjeshtë në përmbajtje dhe pse ka në përbërje elemente të përditshmërisë së praktikës liturgjike që karakterizohen nga ndërtime tipike, nga elemente latine që dhe në tekstet në gjuhën italiane (gjithashtu dhe në gjuhën shqipe) qëndrojnë të tilla, si kujtesë e kanonit roman që mbizotëron sërish pas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit.

Vepërzat në gjuhën shqipe që dalin nga shtypi gjatë shekullit XVII reflektojnë pikërisht gjurmë të një kujdesimi për të cilin vetë autorët japin të dhëna që janë dhe njëfarë orientimi ndaj rrugëtimit që secila ka përshtatur deri në momente të përmbylljes së tyre. Dicionari latinisht-shqip i Frang Bardhit ruan qartësisht elemente që lidhen me një kujdesim

8 Shih në veçanti cilësimet përkatëse të rubrikave në N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma, 1958.

9 Për vënien në dukje me sigla përkatëse të këtyre pjesëve që në krye të krerëve dhe kapitujve (Officium parvum B. Mariae Virginis; Septem psalmi poenitentiales; Litaniae Sanctorum; Officium defunctorum; Rituale; Missale) shih në veçanti N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma, 1958; për një ndarje analitike të ngjashme shih gjithashtu dhe M. Camaj, *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Roma, 1960, *Introduzione*, f.8.

10 M. Genesin, J. Matzinger, *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A. Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017, f.33-47.

të tillë të natyrës institucionale, në të cilën dallojmë dhe siglën e njohur në latinisht “SVPERIORVM PERMISSV”, që në botime të ngjashme mund të ndeshet në gjuhën italiane me ndërtimin *Con licenza de’ superiori*.¹¹

Një ndërlidhje me një prani të tillë e dëshmon dhe vetë teksti hyrës që ka për destinatar kardinalët e Kongregacionit të Propagandës së Fesë, të cilëve qartësisht u detyrohet nga vetë autori dhe mbështetja për shtyp e veprës së tij.¹² Në këtë tekst me të cilin introduktohet Dicionari i sipërcituar do të gjinden të evidentuara dhe të tjera hollësi që lidhen me interpretimin e domosdoshmërisë së botimit të tij, bashkë me vënien në dukje të vendosjes në krah të njëra-tjetrës së dy gjuhëve me të cilat autori ka operuar në krejt ndërtimin e veprës së vet. Mes tekstit hyrës në gjuhën latine dhe atij pasues në gjuhën shqipe ka diferencime të qarta përmbajtësore, duke qenë dhe vëmendja e autorit e orientuar ndaj rolit të kardinalëve të sipërcituar në përrurimin e botimit të tij, fakt që ai shprehimisht do ta shtjellonte në gjuhën latine.

Vumë në dukje të tilla indice në tekstet introductive të veprave të letërsisë së vjetër shqipe të shekullit XVII për të nënvizuar njëherësh dhe një diferencim të qartë me ekzemplarim më të përmendur në historinë e shkrimit shqip, në lidhje me të cilin deri më sot nuk mund të flitet qartësisht për hollësi që na orientojnë ndaj një konteksti të qartë të daljes në dritë shtypit. Në rasë të këtij ekzemplari, të vetmet shënime referenciale ndaj ekzistencës së një shtypshkronje dhe figurës së kujdesuesit gjinden në tekstin përmbyllës të tij, emërtuar dhe konsideruar nga studiuesit e fushës si “kolofon”, term që ka dhe një receptim të qartë e të evidentuar dhe në literaturën gjegjëse studimore të lamijes së filologjisë së tekstit. Brendësimi përmbajtësor i këtij teksti përmbyllës, i pasuruar dhe nga shënimet e vyera të Eqrem Çabejt në vëllimin e dytë të botimit kritik të tij (Tiranë, 1968) sigurisht që nuk lë jashtë vëmendjes dhe përmendjen e shtypësve të veprës, përgatitja e të cilëve në çështje të njohjes së një materieje të tillë të përpiluar në gjuhën shqipe nuk është e ditur me saktësi.¹³

11 Për siglën gjegjëse në gjuhën italiane shih në veçanti dhe botimin e vitit 1618 të Doktrinës së Pjetër Budit, në frontespicin e së cilës lexohet qartësisht kjo e fundit. Për siglën latine “*liberalitate typis datum*” që përmbahet në frontespicin e veprës “*Speculum confessionis*” të Pjetër Budit, shih në veçanti botimin e vitit 1621, shtypur në Romë, pranë trashëgimtarëve të B. Zannettit.

12 Shprehimisht citohet dalja në dritë të shtypit e veprës (Dictionarit) falë mbështetjes së kardinalëve të Kongregacionit të Propagandës së Fesë, bashkë me nënvizimin e veçanësisë së veprës për të cilën më tej autori do të sqarojë dhe arsyet e përpilimit. Për tekstin hyrës në gjuhën latine shih në veçanti B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum*, per R. F. Blanchum (Romë, 1635), Botime Françeskane, Shkodër, 2008, f.71-74. Për tekstin pasues në gjuhën shqipe drejtuar lexuesve dhe transkribimin përkatës shih po aty, botim i cituar, f.75-85.

13 “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555), botim kritik punuar nga E. Çabej, Pjesa e dytë (faksimile dhe transkribim fonetik), Tiranë, 1968, f.387. Në këtë pasazh të veprës shtypësit, stampatorët citohen pikërisht me “*ata qi shtamponjinë*”.

Për të sqaruar në mënyrë përfundimtare nëse ky i fundit kishte qenë objekt i një censurimi rreptësisht ndalues në çështje të përdorimit në funksionet ndaj të cilave ishte i paracaktuar, do të duhej dhe gjetja apo përmendja konkrete në një prej indekseve të librave të ndaluar, të cilët janë të shumtë në numër dhe jo përherë të ngjashëm për nga tematikat e ngushta të përfshira në përmbajtjen e tyre. Për më tepër, dhe vetë emërtimi i tyre dëshmon për një larmi botimesh që zgjerojnë hapësirën e kërkimit dhe të hulumtimit konkret, e vështruar dhe në pikëpamje të ndikimit konkret të kishës së Romës.

Një element që do të duhet të konsiderohet dhe në këtë aspekt është dhe mënyra e citimit apo e përmendjes së një libri të tillë në indeksat e sipërcituara, fakt që rishpie në historikun e emërimit të tij prej paraardhësve, duke filluar me prelatin e sipërcituar, Imzot Gjon Kazazin, i cili për vetë këtë emërtim përmendet si referencë themelore në jo pak studime në lidhje me këtë çështje.¹⁴

Edhe në vetë historikun e trajtimit të përmbajtjes dhe të elementeve që e ndërtojnë një vepër të tillë, emërtesa “meshar” duket qartë që ka krijuar dhe njëfarë lehtësie ndër studiues, me gjithë vetëdijen që në brendinë e tij ngërtheheshin disa modele librash, të gjitha të përshtatshme për të qenë pjesë të një përditshmërie të lidhur me sakramentet, lutjet e përditshme, kushtimet për të vdekurit, celebrimin e meshës etj. Në një vështrim më të gjerë, dhe libra të tjerë mund t'i përmbajnë modelet e gjendura në librin e Buzukut, duke mbetur po aq të përshtatshëm në destinacionin e tyre dhe në çështje të përdorimit në praktikën e liturgjisë, aq e rëndësishme për t'u reflektuar dhe në libra të veçantë e në tekste të paracaktuara, siç mund të evidentohet edhe në shekullin XVII në lidhje me breviarët dhe librat e lutjeve.

Në ato vepra të letërsisë së vjetër shqipe që duket qartë që përmbushin një finalitet të tillë, çdo element përbërës është një e dhënë më vete për të arritur në plotësimin e panoramës përkatëse: himnet që paraqiten të shqipëruara, por me një prani përveçimesh a përdorimesh që flasin qartë për një ndikim latino-roman, lutjet që jo përherë kanë një strukturë të pastër në pikëpamje sintaksore, tekstet biblike që të gjurmueshme në më se një variant, janë një tjetër dëshmi e njohjes nga ana e përpiluesve e modeleve referenciale në të tjera areale. Çështja e gjurmimit të teksteve që reflektojnë një diferencim përmbajtësor në brendi të së njëjtës vepër apo dhe nga vepra në vepër na orienton ndaj një tjetër hulumtimi të mundshëm që ka të bëjë dhe me qarkullimin e librave të tematikës kishtarë në periudha të caktuara.¹⁵

14 Shih në veçanti B. Demiraj, *Viti i zbulimit të Mesharit të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në *Albanistica 5*, (Studi filologici arbëreshë), Collana diretta da F. Altimari, Comet editor Press, Cosenza, 2015, f.65-74.

15 Shih në veçanti B. Demiraj, *Manifestazioni dell'umanesimo cristiano nei testi biblici del*

Ndërkohë, ajo e censurës dhe e mbikëqyrjes që pasqyrohet në vetë tekstet që përpilojnë autorët, por dhe në pjesë të veçanta të veprave të tyre është një tjetër argument që duke u ndjekur në vetë vijimësinë kronologjike me të cilën tradicionalisht e paraqesim në studimet mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, duket qartë që ka qenë e pranishme dhe ka pasur vlefshmërinë e një faktori vlerësues dhe vendimtar në përmbylljen e procesit të shtypit. Prania e tyre nënvizohet dhe në studime të posaçme mbi vetë periudhën e lëvrimin të kulturës librare, në veçanti në periudhën posttridentine, që u pasua nga zhvillime të përveçme në vende të tjera, duke filluar nga ato të lidhura ngushtësisht me kishën e Romës. Është e drejtë që edhe çështja e librit të Gjon Buzukut të shihet e pandarë nga ajo e ndikimit dhe e reflektimit të dekretëve tridentine në fatin e mjaft veprave dhe librave të paracaktuar për një praktikë të qartë përdorimi. Përmbajtja e tij, gjurmimi i modeleve librare që pasojnë njëri-tjetrit e që janë të vlefshëm në pikëpamjen praktike të përdorimit mund të interpretohet pikërisht në këtë optikë të funksionalitetit kompleks që i gjen edhe lutjet, edhe tekste konkrete prej tij të jenë pjesë e një konteksti të caktuar përdorimi.¹⁶

Në hapësirën kohore që shoqëron përpilimin e veprave të shekullit XVII gjithnjë me një tematikë që lidhet me botën kishtarë, ndodhin të tjera zhvillime dhe që reflektohen në një tjetër tipologji të ndërtimit të këtyre të fundit.¹⁷ Duke u nisur dhe nga evidentimi i zhvillimeve të tilla, mund të argumentohet dhe njëfarë diferencimi në studimet që janë kryer e vijnë në kryhen mbi librin e parë të njohur deri më sot në gjuhë shqipe, nga vëzhgime që lidhen me vepra pasardhëse, më të identifikueshme për nga elementet e përmbajtjes, por dhe të konfigurimit formal të tyre.

Vetë burimet bibliografike që në dekadat e fundit i janë bashkëngjitur pasurisë së konsiderueshme në studime të përveçme, në trajtesa të thelluara që lidhen me historinë e përvijimit të veprave të veçanta, janë një tjetër dëshmi e mundësive të shumta e të pashteruara për të hulumtuar më tej në botën e librit dhe në kulturën e njohjes së tij në vështrim diakronik, por dhe gjeografik e kulturor. Çka i bashkon veprat e letërsisë së vjetër shqipe mbetet pikërisht dhe të shkruarit e tyre në gjuhën e vendit, me një prani të spikatur të elementit latin e atij latino-roman, fakt që bëhet më i gjurmueshëm në rasë të lutjeve apo himneve që në disa tekste ruajnë të qartë ndikimin nga variante të përpiluara më herët në gjuhët e praktikës së

«Messale» di Gjon Buzuku, në *Shëjzat*, n.1-2, 2024, f.3-42.

16 E. Paci, *Përimtime e refleksione mbi historikun e një ekzemplari të rrallë në historinë e shkrimit shqip*, në *Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022.

17 Shih dhe vështrimin përkatës mbi autoritetin papnor gjatë shekullit XVII në Ronnie Po-Chie Hsia, *La Controriforma (Il rinnovamento del mondo cattolico: 1540-1770)*, Biblioteca storica, Bologna, 2001, f.138-140.

liturgjisë në viset në të cilat besimi i krishterë kultivohej gjerësisht dhe me një vijimësi tradicionalisht të njohur për lidhjen me gjuhën latine.

BIBLIOGRAFI

- A. Omari, *"Doktrina e kërshen" e Gjon Kazazit dhe botimi kritik i saj*, në *Hylli i Dritës*, n.1.2017.
- A. Omari, *Studime rreth shqipes së vjetër (shekujt XV-XVIII)*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022.
- B. Demiraj, *Viti i zbulimit të Mesharit të Gjon Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të*, në *Biblos*, Palermo, 2003.
- B. Demiraj, *Gjon P.Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006.
- B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum, per R.F.Blanchum (Romæ, 1635)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- B. Demiraj, *Studi filologjici arbëreshë*, në *"Albanistica" (seri veprash drejtuar nga F.Altimari)*, Nr. 5, Comet Editor Press, Cosenza, 2015.
- B. Demiraj, *Areali kulturor i Veriut në shek.XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.
- B. Demiraj, *Manifestazioni dell'umanesimo cristiano nei testi biblici del "Messale" di Gjon Buzuku, në Shêjzat*, n.1-2, 2024.
- E. Paci, *Doktrina e Kërshenë e Gjon Nikollë Kazazit (1743), një sintezë katekeze e didaktike*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2016.
- E. Paci, *Gunnar Svane: Kontribute themelore mbi interpretimin e tekstit dhe filologjik të veprës së Pjetër Budit*, në *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2018.
- E. Paci, *Early doctrinal variants in a context of the history of Albanian written literature*, në *Studia Albanica*, n.2, 2021.
- E.Paci, *Koncili i Trentit (1545-1563) në një panoramë vëzhgimesh mes historiografisë dhe studimeve letrare*, botuar në aktet e Kuvendit të dytë të Studimeve Albanologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022.
- E. Paci, *Përimtime e refleksione mbi historikun e një ekzemplari të rrallë në historinë e shkrimit shqip*, në *Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022.
- E. Paci, *Rreth një vështrimi sistemor mbi iniciimin e lëvrimin të shkrimit shqip dhe reflektim të mundshme të zhvillimeve evropiane (shekujt XVI-XVII)*, në *Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022.
- E. Paci, *Rreth librit kishtar të shtypur në gjuhën shqipe: ekzemplarë hershmërie*

- dhe ndikimesh kulturore në shekujt XVII-XVIII, në Buletinin Shkencor të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", n.72, 2022.
- E. Paci, *Pjetër Budi, Vepra II, Speculum Confessionis/Pasëqyra e t' Rrëfyemit (1621), Riprodhim anastatik i botimit kritik të Gunnar Svane-s (1986), përgatitur dhe pajisur me faksimilet e tekstit burimor nga Bardhyl Demiraj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2023, në Studime filologjike, n.2, 2024.*
- E. Paci, *Të dhënat dokumentare dhe historiku i njohjes së teksteve të vjetra shqipe, në Studime filologjike, n.2, 2025.*
- G. Caravale, *L'orazione proibita. Censura ecclesiastica e letteratura devozionale nella prima età moderna*, Olschki editore, Firenze, 2003.
- G. Fragnito, *La censura ecclesiastica in Italia: volgarizzamenti biblici e letteratura all'Indice. Bilancio degli studi e prospettive di ricerca, në Reading and censorship in Early Modern Europe*, Barcelona, 2010.
- G. Fragnito, *La Bibbia al rogo: La censura ecclesiastica e i volgarizzamenti della Scrittura*, Il Mulino, Bologna, 2015.
- G. Fragnito, Tallon A., *Hétérodoxies croisées. Catholicismes pluriels entre France et Italie (XVI et XVII siècle)*, Publications de l'Ecole Française de Rome, 2015.
- G. Marlekaj, *La più antica pubblicazione in lingua albanese, në Quaderni dell'Istituto di Glottologia, III (1958)*, Bologna, 1959.
- G. Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura albanese (a cura di M.Mandalà)*, Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- I. Zamputi, *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare, në Studime filologjike n.3, 1986.*
- J. Matzinger, *L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale ("Messale") di Gjon Buzuku, në Hylli i Dritës, nr. 4, 2010.*
- L. Nadin, *"Meshari" i Gjon Buzukut. Të dhëna të reja, skenare të reja, në Studime filologjike, n.1-2, 2019.*
- M. Genesin, J.Matzinger, *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta, në L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide, a cura di A.Ndreca*, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- M. Caffiero, *Aggirare la censura. Circolazione del libro e sfera pubblica in età moderna, në Rivista di storia del Cristianesimo, n.2, 2012.*
- M. Camaj, *Prilog poznavanju grafije Gjon Buzuka, në Godisniak, 1, Balkanoloski Institut, Sarajevo, 1957.*
- M. Camaj, *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shëjzat, Romë, 1960.*
- M. Cavarzere, *La prassi della censura nell'Italia del Seicento. Tra repressione e mediazione*, Edizioni di storia e letteratura, Roma, 2011.

- M. Infelise, *I padroni dei libri. Il controllo sulla stampa nella prima età moderna*, Laterza, Bari, 2014.
- M. Mandalà, *Gli archivi ecclesiastici e la memoria storico-culturale arbëreshë. Un bilancio di tre decenni di ricerche*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
- M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
- M. Roques, *Deux livres d'heures du XVIe siècle en cyrillique bosniaque*, në *Revue des études slaves*, v.12, n. 1-2, 1932.
- M. Roques, *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe, përkthyer nga origjinali e pajisë me shënime plotësuese nga W.Kamsi*, në Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës, numër i posaçëm, 1964.
- N. Ressuli, *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Città del Vaticano, Biblioteca Apostolica Vaticana, Roma, 1958.
- R. P.Hsia, *La Controriforma (Il rinnovamento del mondo cattolico: 1540-1770)*, Biblioteca storica, Bologna, 2001.
- W. Kamsi, *Gjon Buzuku e Koncili i Trentit*, në *Buzuku dhe gjuha e tij*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2005.

